

GJYKATA EVROPIANE E TË DREJTAVE TË NJERIUT
SEKSIONI I TRETË

VENDIM
Kërkesa nr. 10893/09

Genc BUSHATI kundër Shqipërisë
dhe dy kërkesa të tjera
(shih tabelën bashkëngjitur)

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Seksioni i Tretë), e mbledhur më 25 gusht 2022, si Komision, i përbërë nga:

Andreas Zünd, *kryetar,*

Darian Pavli,

Mikhail Lobov, *gjyqtarë,*

dhe Viktoriya Maradudina, *zëvendëssekretare e përkohshme e Seksionit,*

Pasi morën në konsideratë kërkesat e mësipërme paraqitur në data të ndryshme, sipas tabelës bashkëngjitur,

Pasi mori në konsideratë parashtrimet e paraqitura nga Qeveria e paditur, si edhe parashtrimet e kërkuarit si përgjigje ndaj të parave,

Pasi diskutoi, vendos si më poshtë:

FAKTET DHE PROCEDURA

Lista e kërkuarve gjendet në tabelën bashkëngjitur.

Kërkuari i parë u përfaqësua nga Z. B. Muslija, një avokat, i cili e ushtron profesionin në Shkodër. Kërkuari i dytë dhe i tretë u vetëpërfaqësuan.

Ankesat e kërkuarve sipas nenit 6 § 1 të Konventës në lidhje me kohëzgjatjen e tepërt të procedurave civile, së bashku me ankesat e tyre sipas nenit 1 të Protokollit nr. 1 të Konventës, në lidhje me vonesën në shlyerjen e kompensimit ndaj tyre, iu komunikuan Qeverisë shqiptare (“Qeveria”). U komunikuan gjithashtu edhe kërkesat nr. 11170/09 dhe 49039/11 *ex officio*, sipas nenit 13, në lidhje me çështjen nëse kërkuarit kishin në dispozicion një mjet efikas të brendshëm për t’u ankuar për kohëzgjatjen e procedurave civile.

LIGJI

A. Bashkimi i kërkesave

Duke marrë në konsideratë lëndën e ngjashme të kërkesave, Gjykata e gjykon me vend që t’i shqyrtojë së bashku, si një vendim i vetëm.

B. Ankesa në mbështetje të nenit 6§1 të Konventës (kohëzgjatje e tepruar e procedurave civile)

Kërkuarit u ankuar në mbështetje të nenit 6 për faktin se kohëzgjatja e procedurave administrative përpara Ministrisë së Drejtësisë në lidhje me dhënien e vendimit për pretendimet e tyre për kompensim ishte në shkelje me kushtin për “afat të arsyeshëm” sipas nenit 6 § 1 të Konventës.

Duke marrë në konsideratë nenin 6§1, i cili parashikon të drejtën për t’u dëgjuar brenda një afati të arsyeshëm përpara një gjykate, Gjykata vëren se ky nen nuk zbatohet për procedurat plotësisht administrative, si ato në çështjen në fjalë (krahaso *Blake kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 68890/01, §40, 26 shtator 2006, me referenca të tjera).

Për këtë arsye, në lidhje me kohëzgjatjen e pretenduar të procedurave përpara Ministrisë së Drejtësisë, Gjykata thekson se ky autoritet nuk është një “gjykatë”. Në përputhje me rrethanat, kjo pjesë e kërkesës nuk përputhet *ratione materiae* me Konventën dhe duhet të rrëzohet në përputhje me nenin 35§§3 dhe 4 të Konventës.

C. Ankesa sipas nenit 1 të Protokollit nr. 1 të Konventës

Ankesa e kërkuarit për shlyerjen e vonuar të kompensimit të tyre nga autoritetet si ish-të burgosur politikë gjatë regjimit Komunist, shqyrtohet sipas nenit 1 të Protokollit nr. 1 të Konventës.

Gjykata thekson se shtetet përjashtohen nga kërkesa që të përgjigjen përpara një organi ndërkombëtar për masat e tyre, përpara se të kenë mundësinë që t’i zgjidhin çështjet me anë të sistemit të tyre ligjor, dhe ata që dëshirojnë të kërkojnë juridiksionin mbikëqyrës të Gjykatës, për sa ka të bëjë me ankesat ndaj një Shteti, janë të detyruar të përdorin fillimisht mjetet e ofruara nga sistemi i brendshëm ligjor (shih *Vučković dhe të tjerët kundër Serbisë* (kundërshtim paraprak) [DHM], nr. 17153/11 dhe 29 të tjerë, §70, 25 mars 2014, me referenca të tjera). Në kërkesat konkrete, kërkuarit nuk e kundërshtuan zbatimin e vonuar të vendimit administrativ i cili u akordonte kompensim përpara gjykatave të brendshme administrative.

Kjo pjesë e kërkesave duhet të deklarohet e papranueshme pasi mjetet e brendshme nuk janë shteruar sipas nenit 35 § 1 të Konventës.

D. Shkelje të tjera të pretenduara të Konventës

Në lidhje me ankesat e tjera të paraqitura nga kërkuarit, Gjykata është e mendimit se, në mbështetje të të gjithë materialit që ajo zotëron, dhe për sa çështjet për të cilat është bërë një ankesë janë në kompetencën e saj, këto ankesa ose nuk përmbushin kriteret e pranueshmërisë të parashikuara në nenet 34 dhe 35 të Konventës, ose nuk paraqesin ndonjë formë të shkeljes së të drejtave dhe lirive të parashikuara në Konventë ose në protokollet e saj.

Për këtë arsye, kjo pjesë e kërkesave duhet të rrëzohet në mbështetje të nenit 35§4 të Konventës.

Për këto arsye, Gjykata, në mënyrë unanime,

Vendos t’i bashkojë kërkesat;

I deklaron kërkesat të papranueshme.

Hartuar në anglisht dhe njoftuar me shkrim, më 15 shtator 2022.

Viktoriya Maradudina
ZËVENDËSEKRETARE E PËRKOHSHME

Andreas Zünd
KRYETAR

SHTOJCË

Lista e ankesave të cilat parashtrojnë ankesa sipas nenit 6§1 të Konventës
(kohëzgjatje e tepërt e procedurave civile)

Nr.	Kërkesa nr. Data e paraqitjes	Emri i kërkuarit Viti i lindjes	Emri dhe vendndodhja e përfaqësuesit
1	11170/09 21/11/2008	Genc BUSHATI 1944	Muslija Bashkim SHKODËR
2	65326/09 07/10/2009	Osman MENA 1959	
3	49039/11 13.06.2011	Nazmi JUSUFI 1939	